



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:012464

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04857143

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.48/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të pandehurit Gzim Nikçi nga fshati Reka e Allagës, komuna e Pejës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.99/2021 të datës 25.01.2021, për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 25.10.2023, në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit Gzim Nikçi me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av.Haki Mavraj, të njejtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 30.10.2023, përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

Gzim Nikçi, i lindur me 05.04.1962, i biri i Sylejmanit dhe nënës Hasime e gjinisë Nikçi, i martuar babë i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër 1003682630 – lëshuar nga MPB R-Kosovës, posedon telefon me nr.048/678-668, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Më parë e gjer me datën 03.12.2020 rreth orës 11:30 në fsh. Reka e Allagës (Rugovë) K.Pejë, me dashje dhe në kundërshtim me Ligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” me nr. 04/L-086 dhe atë nenin 3 pika 1.3 e lidhur me Ligjin për Ndërtim nr. 04-L/110-neni 14 i pandehuri Gzim në pronën e cila është në emër të tij ka ndërtuar themelin e dy objekteve me destinim vila në atë mënyrë që: i njëjti në kohën dhe në vendin e lartcekur e fillon ndërtimin me material të fortë të një vile, ndërsa ishte në përfundim të një objekti (katër vilave nën një kulem)

me punim bazë druri, te gjitha këto pa leje ndërtimore në pronën e cila është pjesë e territorit të parkut kombëtar, këto punime me datën e lartcekur i janë ndërprerë nga ana e zyrtareve policor dhe zyrtareve të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

- me këtë ka kryer veprën penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

#### GJYKON

- Të pandehurit Gzim Nikçi i shqipton:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- RRENOHET objekti i ndërtuar pa leje, i përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, shpenzimet për rrenim i bart i dënuari.
- Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

#### ARSYETIM

- Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 25.01.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.99/2021 kundër të pandehurit Gzim Nikçi, për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 25.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri Gzim Nikçi me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av.Haki Mavraj, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit, në kuptim të nenit 322 par.1 dhe 4 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi " Pas pranimit të fajësisë nga na e të akuzuarit Gzim Nikqi, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kryesor, u vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprë penale për të cilën akuzohet, e kjo u vërtetuar edhe nga deklaratat e të pandehurit e dhënë në prokurori me dt.07.12.2020, i cili kishte deklaruar në po të njëjtën mënyrë sikur sot, se është e vërtetë se kam ndërtuar katër villa me material druri dhe një villë me material të fotë, për të cilat nuk ka pas leje ndërtimi, nga procesverbali për kontroll inspektues të kryer me nr.000104, në bazë të të cilit është konstatuar se në vendin e quajtur "Reka Allagës", i pandehuri është Hsur duke ndërtuar disa villa në pronën e tij, fotografitë e vendit të ngjarjes nga të cilat shihet se i pandehuri ka filluar ndërtimin e katër vilave nën një kulëm e material druri dhe një objekt tjetër me material të fortë dhe për të njëjti ju kanë vu edhe shiritat për ndalimin e punës, nga certifikata e pronësisë nga e cila shihet se këtu i pandehuri është pronar i ngastrave kadastrale në të cilat janë ndërtuar objekt në fjalë. Andaj nga sa u tha më lartë mbes në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj, si dhe propozimeve tjera në aktakuzë, ashtu që nga Gjykata kërkoj që të pandehurin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas Ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur nga i pandehuri, ti vlerësoj si rrethanë lehtësuese".

Mbrojtësi i të pandehurit, Av.Haki Mavraj në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi: "Desha të ndërlidhem me fjalën e prokurorit kur tha se Gzimi është banor rezident në Rugovë, ka jetua edhe para luftë ku ka pas objekt banimi, sa i përket çështjeve tjera mbetem prne thënieve të mija si më lartë".

I pandehuri deklaroi " Ku janë të ndërtuara villat para luftës e kam përdorë si punëtori, por gjatë luftës është djegë komplet gjithashtu e kam pas edhe shtallën për gjo, më vjen që ka ndodhë ky rast".

- Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 1 (një) viti për të pandehurin u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, është dënimi prej katër vite burgim.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së, gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.2 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit me kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej katër (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.2 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, e në këtë rast gjykata gjeti se mund të zbatohet dispozita për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 pika 2 dhe 3 të KPRK-së, përkitazi me kushtëzimin e dënimit me burgim, përkatësisht duke u bazuar në faktin se i pandehuri e pranoj fajësinë në fillim të seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe se i pandehuri shprehu keqardhje të thellë me rastin pranimit të fajësisë.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së, dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Kur u vendos për rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje e të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 359 par.5 të KPRK-së, ku është paraparë se “Ndërtimi pa leje në këtë nen duhet të rrënohet dhe shpenzimet e rrënimin barten te kryesi”, pra dispozita materiale ka paraparë që objekti i ndërtuar pa leje duhet që të rrënohet dhe kjo nuk është dispozitë alternative për gjykatën është normë obligative.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në faktet e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal  
P.nr.48/21, me datë 30.10.2023

Procesmbajtësja:  
Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjyqësor:  
Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë